NJERIU ËSHTË KRIJUAR PËR TË JETUAR ME DINJITET...

SULMI NDAJ IMAM BUHARIUT ËSHTË SULM NDAJ ISLAMIT NË PËRGJITHËSI

POETËT OSMANË TË VILAJETIT TE SHKODRËS

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 18 - Nr. 7 (209), Korrik, 2020

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Xhamia e madhe "Ajasofja" rihap dyert për besimtarët e mbarë botës

Ajasofja ka shërbyer si xhami për 481 vjet ndërsa në 86 vitet e fundit ka shërbyer si muze pas një vendimi të Këshillit të Ministrave të datës 2 Nëntor 1934. Ndërkohë, më 10 Korrik 2020 me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe me miratimin e presidentit Erdogan, Ajasofja nga muze, u rikthye në xhami...

Kurban Bajrami është dita e familjes, e rizgjimit!

Kjo është një ditë e madhnueshme për mbarë universin, kjo është dita e tekbirit dhe e përvetësimit të kuptimeve të thirrjes "All-llahu ekber" në jetën e besimtarit dhe në jetën e çdo njeriu!

Kjo është dita, ku nga lindja në perëndim njerëzit dhe të gjitha krijesat thërrasin "All-llahu ekber", All-llahu është më i madhi!

Në fakt në jetën e besimtarit ka momente në të cilat All-llahu (xh.sh.) e thërret vëmendjen e gjithsecilit prej nesh, për t'u kthyer tek origjina e krenarisë dhe të jetuarit me dinjitet, si krijesa me e dashur e Zotit, e si krijesa që Zoti i gjithësisë e përzgjodhi për të mbartur më të madhin e amaneteve që nuk e mbarti dot as qielli e as toka, as malet, askush përveç njeriut.

KURBAN BAJRAMI ËSHTË DITA E FAMILJES, E RIZGJIMIT!

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të dashur besimtarë!

Kjo është një ditë e madhnueshme për mbarë universin, kjo është dita e tekbirit dhe e përvetësimit të kuptimeve të thirrjes "All-llahu ekber" në jetën e besimtarit dhe në jetën e çdo njeriu!

Kjo është dita, ku nga lindja në perëndim njerëzit dhe të gjitha krijesat thërrasin "All-llahu ekber", All-llahu është më i madhi!

Në fakt në jetën e besimtarit ka momente në të cilat All-llahu (xh. sh.) e thërret vëmendjen e gjithsecilit prej nesh, për t'u kthyer tek origjina e krenarisë dhe të jetuarit me dinjitet, si krijesa me e dashur e Zotit, e si krijesa që Zoti i gjithësisë e përzgjodhi për të mbartur më të madhin e amaneteve që nuk e mbarti dot as qielli e as toka, as malet, askush përveç njeriut.

Mirëpo kaloi një kohë e gjatë që njeriu u hutua, dhe njeriu e humbi busullën e orientimit duke humbur rrugën e Zotit. Por All-llahu (xh.sh.), na krijoi nga dashnia e Tij për ne, dhe na pajisi me çdo cilësi, çdo virtyt dhe çdo mundësi e aftësi për ta zhvilluar jetën në këtë tokë. All-llahu (xh.sh.) na dëshmoi që në krye të herës për dashninë e Tij karshi nesh, sepse bëri që edhe melekët të bien në sexhde përpara urdhrit të Tij (xh.sh.) në momentin kur krijoi të parin tone, Hz. Ademin (a.s.)!

Prandaj sot është dita që gjithsecili të ndjejë me zemër dhe me shpirt, dhe të dëshmojë me thellësinë e zemrës së tij se All-llahu është më i madhi. Është më i madh edhe se tekat e kapriçot e njeriut, është më i madh edhe se sa devijimi e shthurja e racës njerëzore, është më i madh edhe se sa çdo përpjekje e çdokujt në botë për ta bërë njeriun për të jetuar larg vullnetit të Zotit dhe larg pëlqimit të Tij, në jetën e përkohshme të kësaj bote.

Të dashurit e mi!

Përpara se të vija në këtë tubim të begatë po ndiqja përfundimin e rrugëtimit të haxhilerëve të përzgjedhur të këtij viti, ndonëse në një numër shumë të vogël, ndonëse jo ashtu sikurse do të dëshironim, porse haxhilerët e këtij viti, si ata të çdo viti të kaluar dëshmuan me bardhësinë e zemrave të tyre, të veshur me të bardhat e kësaj bote; forcën e besimit dhe lartësimin e emrit të All-llahut (xh.sh.) në më të mirin e më të shenjtin e vendeve të kësaj bote.

Kaluan ditën e djeshme në adhurime, kaluan momentet më të mrekullueshme të vitit në fushën e Arefatit, ashtu sikurse ne, që u bashkuam me haxhilerët dhe iu përgjigjëm thirrjes së Pejgamberit (a.s.) për ta agjëruar atë ditë të bekuar, më të mirën e ditëve të vitit!

U bashkuam me haxhilerët në përshpirtjen e atij tubimi të mrekullueshëm, që mishëron më së miri mëshirën që Zoti i gjithësisë ka për krijesat e Tij, që mishëron më së miri përgjigjen që njeriu në çdo kohë i bën Zotit të tij duke thënë: "Lebejkall-llahumme lebejk!".

Të dashurit e mi!

Jeta e jonë është e përkohshme, është kalimtare dhe kemi shumë nevojë që në çdo moment të saj, t'i thërrasim zemrës dhe mendjes për të kërkuar në vetveten tonë elementët që na lidhin me këtë thirrje të begatë: "Lebejkall-llahumme lebejk!".

A i jemi përgjigjur ne Zotit tonë në realitet e përditshme? A jemi ne ymeti më i mirë? "Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve..."![1] A jemi ne sot dëshmia më e mirë në mesin e popujve; më të diturit, më të organizuarit, më të fortët ekonomikisht, më të fortët në dije, më të fortët në industri, më të fortët në politikë, më të fortët në...?

Kjo është një pyetje që duhet ta bëjë gjithsecili prej nesh, dhe jo të drejtojmë gishtin sa majtas-djathtas, sepse nëse nuk e rregullojmë veten tonë, dhe nëse nuk pranojmë gabimet, e nëse nuk ngrihemi për t'iu përgjigjur Zotit të gjithësisë drejt asaj që është më e mira: "O ju të cilët keni besuar, përgjigjuni thirrjes së All-llahut dhe të të Dërguarit kur ai ju fton për atë që ju jep jetë..!"[2], nuk do të na ketë vlerë më asnjë fjalë!

A e kemi kuptuar mesazhin e fesë si jetë që na vjen nga Zoti i gjithësisë? A e kemi kuptuar mesazhin e fesë si një mundësi që na vjen nga Krijuesi Fuqiplotë, për të jetuar me dinjitet e krenari në këtë botë të përkohshme, apo e kemi kthyer fenë tonë, a fetarizmin tonë, si një shfaqje folklorike dhe një shfaqje sipërfaqësore? A jemi ne sot në këmbë të sahabëve të Pejgamberit (a.s.)? A është rinia jonë sot, në këmbë të të rinjve që shoqëruan Pejgamberin (a.s.), që përvetësuan thirrjen e teuhidit, e përvetësuan thirrjen e mesazheve të Pejgamberit (a.s.) dhe jetuan me ato thirrje, duke u bërë gjithsecili prej tyre, diell ndriçuese në realitetet e tij?

Lexuam dhe vazhdojmë të lexojmë, e të shohim gjurmët e sahabëve të Pejgamberit (a.s.) nga njëri cep i botës në tjetrin. Çfarë e ka dërguar djalin e xhaxhait të Pejgamberit (a.s.) ta ketë varrin e tij sot në Kinë? Çfarë e ka dërguar njërin e tjetrin prej sahabëve të Pejgamberit (a.s.) të kenë varret e tyre në Damask dhe në rrethinat e tij? Çfarë i ka dërguar sahabët e Pejgamberit (a.s.) të vdesin e të varrosen në Jordani? Çfarë i ka dërguar të afërmit e Pejgamberit (a.s.) të kenë tyrbet e tyre në Qipro? Çfarë e ka sjellë Ebu Ejub Ensarin në muret e Kostandinopojës së lashtë, aty ku të gjithë ne kur shkojmë për të vizituar Stambollin, shkojmë tek një copë dhe tek një hise e Medines së Ndriçuar, në lagjen e Sulltan Ebu Ejubit?

Që do të thotë se kjo thirrje e begatë gjallëron mbi supet dhe vullnetet e burrave të përkushtuar, prandaj të dashurit e mi sot në ditën, kur lartësohet emri i madhnueshëm i All-llahut (xh.sh.), dhe të gjithë themi: "All-llahu ekber" dhe të gjithë përsërisim pas namazeve farze tekbirët e teshrikut, është momenti për të bërë një llogaritje gjithsecili në veten e tij, se a e kemi kuptuar drejtë fjalën e Zotit? A e kemi lexuar siç duhet fjalën e All-llahut (xh.sh.) në Kur'anin Famëlartë? A e kemi lexuar siç duhet fjalën e Pejgamberit (a.s.), apo jemi hutuar pas disa thirrjeve edhe bashkëkohore drejt të cilave na kanë marrë hutimthi për të na larguar nga thelbi i fjalës, drejt anës së jashtme dhe pamjes së saj?

Të dashurit e mi!

Gjatë këtyre ditëve kam jetuar me modelin e asaj familjeje të bekuar të cilën All-llahu (xh.sh.) e bëri shembull në Kur'anin Famëlartë, atë "Ehli Bejt" të madhnueshëm të cilët All-llahu i Madhëruar i përmendi në Kur'anin Famëlartë: "All-llahu i zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi të gjithë njerëzit (e kohës së tyre)."[3], ndërsa Pejgamberi (a.s.) na edukoi dhe na mësoi që atë "Ehli Bejt" t'i përmendim 5 herë në ditë teksa lexojmë salavatet dhe lutjen "Ettehijjatu", Ehli Bejti i Hz. Ibrahimit (a.s.)! Hz. Ibrahimi (a.s.), zonja e tij e nderuar Haxhere, dhe i biri i tyre Hz. Ismaili (a.s.). Kam jetuar me modelin e tyre dhe, subhanallah kam vënë re se kuptimet e Kurban Bajramit nuk janë asgjë tjetër veçse një nxitje dhe një thirrje hyjnore për të pasur përherë në vëmendje edukimin e familjes dhe përkujdesjen për fëmijët dhe brezin e ri!

Kurban Bajrami është dita e familjes të dashurit e mi, është modeli i babait të përkushtuar i cili i bindet All-llahut (xh.sh.) edhe për të dërguar zemrën e tij, shpirtin e tij, dritën e syve të tij, atë djalë të bekuar, i cili i erdhi në një moshë shumë të thyer, për ta vendosur në një vend të cilin Kur'ani Famëlartë e përshkruan si "një luginë pa asnjë lloj gjelbërimi"! Cili babë e bën këtë? Cili burrë e braktis bashkëshorten lehonë dhe fëmijën e vogël në një shkretëtirë të pabanuar, larg njerëzve, larg qytetërimit? Hz. Ibrahimi (a.s.) e bën këtë, sepse All-llahu (xh.sh.) e ka kërkuar një gjë të tillë.

Por, nga ana tjetër çfarë është kjo grua e devotshme, çfarë është kjo grua e madhe, e cila i bën vetëm një pyetje bashkëshortit të saj? I thotë: "O Ibrahim, a All-llahu të ka urdhëruar që të na lësh në këtë vend?" - I thotë: "Po, All-llahu më ka urdhëruar", teksa largohet prej tyre... Dhe, kjo zonjë e nderuar dhe ky model

1. Kur'ani, Ali Imran: 110.
2. Kur'ani, El-Enfal: 24.
3. Kur'ani, Ali Imran: 33.

MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS ME RASTIN E KURBAN BAJRAMIT 1441/2020

Të dashur dhe të shtrenjtë besimtarë,

Sot është dita e Arefatit. Më e mira ditëve, të cilën, All-llahu i Madhëruar e bëri moment reflektimi dhe adhurimi, hapësirë lutjesh dhe agjërimi, mundësi afrimi dhe pendimi, rrugëtim drejt mëshirës dhe faljes së Tij, me të cilat i gëzon robët e Tij që kërkojnë pëlqimin dhe bekimet e Zotit në jetë!

Sot është dita e Arefatit, në fushën e së cilës, haxhilerët mblidhen për të kaluar momentet më të rëndësishme të Haxhit të çdo viti, por edhe përtej tyre, mbarë njerëzimi mbulohet në këtë ditë me mëshirë e mundësi për të gjetur vetveten para duarve të Krijuesit të gjithësisë!

Dita e Arefatit, që i paraprin Kurban Bajramit, është dita në të cilën, Zoti i gjithësisë i shpalli Hazreti Muhammedit (a.s.) dëshminë e përbotshme: "Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fé" – (El-Maide: 3)

Pra, në këtë ditë, krejt bota islame është e ftuar për t'u kthyer tek origjina e lavdisë dhe krenarisë, organizimit dhe unitetit, bashkëpunimit dhe shtrirjes së dorës së vëllazërisë së shenjtë të këtij Islami të pastër e të plotësuar, për të dëshmuar së bashku madhështinë e thirrjes hyjnore: "Mëshira Ime ka përfshirë çdo send. Atë (Mëshirën) do ta caktoj për ata, të cilët u ruhen mëkateve..." – (El-Arafë: 156)

Ky është momenti që të gjithë pasuesit e kibles së teuhidit, ndjekësit e mësimeve të Hz. Muhammedit (a.s.) dhe krejt ata që besojnë në madhështinë e mesazheve të Kur'anit, të gjuajnë me mosbindje shejtanët, që prej kohësh e kanë shkatërruar jetën mbi tokë dhe akoma vazhdojnë, të hedhin pas krahëve hutimin dhe devijimin, të rizgjohen dhe të kapen pas karvanit të rimëkëmbjes së madhe, shkëlqimi i së cilës ka nisur të ndriçojë prej kohësh!

Ky është momenti për të dëshmuar në paqe dhe plot dinjitet në marrëdhënie me veten dhe me Zotin, me tjetrin dhe me vetë jetën, krenarinë e përkatësisë sonë islame, duke punuar ditë pas dite për lartësimine Fjalës së All-llahut, duke u angazhuar për të përhapur mirësi e dritë, harmoni e vlera, dinjitet e respekt, me këdo prej krijesave të Zotit Një, si dëshmitarë të mrekullive të Tij, si pasues të Dritës së Tij, si besnikë të Shpalljeve të Tij, me të cilat na nxori nga errësirat në dritë!

Me zemër të mirë e begati Kurban Bajramin!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 30 korrik 2020

3

për krejt gratë muslimane deri në fund të kësaj bote, i thotë një fjali të shkurtër, që duhet ta shkruajmë me shkronja të arta: “Meqenëse të ka urdhëruar All-llahu, atëherë Ai nuk do të na humbë!”.

Pra, a nuk është momenti që gjithsecili prej nesh, teksa lexojmë shembullin e Hz. Ibrahimit (a.s.) dhe të bashkëshortes së tij, t’i përgjigjemi vetes tonë dhe kujtdo në botë, teksa na përmenden urdhëresat dhe ndalesat e ndryshme në Kur’an; të themi me bindjen më të madhe se nëse All-llahu (xh.sh.) e ka kërkuar këtë prej nesh, All-llahu (xh.sh.) e di më të mirën dhe nuk do të na humbë nëpërmjet veprimit, a mosveprimit të asaj që ka kërkuar; veprimit të urdhëresave, dhe mosveprimit të të kundërtës së tyre?!

Shembull i mrekullueshëm!

Në këtë djep besimi është përkundur edhe i madhi Hz. Ismail (a.s.), i cili në një moshë të re dëgjon nga babai i tij, pejgamber, i cili i thotë se All-llahu (xh.sh.) e ka urdhëruar që ta bëjë kurban fëmijën e tij. – “O djalli im, unë kam parë (jam urdhëruar) në ëndërr të pres ty. Shiko pra, çka mendon ti?”. Kjo është një përkëdheli nga babai, i cili e di shumë mirë se kjo ëndërr është një shpallje hyjnore, dhe djali i bindur, modeli i djemve të rinj dhe shembulli i djemve që kërkon Islami, i thotë babait të tij: “O babai im, punoje atë që urdhërohesh, e ti do të më gjesh mua, nëse do All-llahu, prej të durueshmëve!”.

Po si mendoni të dashurit e mi, se një familje e tillë, a nuk do të jetë shembull, dhe a nuk do të përjetësohet nga Zoti i gjithësisë: *“All-llahumme sal-li ala sejjidina Muhammed, ve ala ali sejjidina Muhamed, kema sal-lejte ala Ibrahime ve ala ali Ibrahim...”!*

Ne vazhdojmë ta lexojmë këtë lutje, ku përmendet me respekt dhe nderim Hz. Ibrahimi dhe Ehli-Bejti i tij (familja e tij shembullore), mbi 10 herë në ditë, për çdo namaz farz, për çdo namaz synet, për namazet nafile. Me dhjetra herë në ditë e lexojmë këtë. A e kemi kuptuar arsyen se përse All-llahu (xh.sh.) na e ka përmendur Hz. Ibrahimin (a.s.) në çdo namaz prej namazeve tona?

Dita e Kurban Bajramit është momenti që djemtë e rinj të kuptojnë se e ardhmja është përreth familjes, e ardhmja është tek respekti ndaj prindit, e ardhmja është tek vlerësimi i babait dhe i nanës sa janë në këtë botë, se e ardhmja dhe bekimet e All-llahut (xh.sh.) në këtë botë nuk janë tek ata të rinj, të cilët e humbin kohën duke shëtitur rrugëve dhe rrugicave pa asnjë dobi, e ardhmja dhe bekimet e All-llahut (xh.sh.) nuk janë tek ata njerëz, të cilët e humbin kohën e tyre duke u kthyer në njerëz të rëndomtë pa asnjë lloj vlere, as për babain, as për nënën, as për familjen, as për vëlla, as për motër dhe as për shoqëri!?

Të ndjehemi krenarë me fenë tonë, të ndjehemi krenarë në fenë tonë të dashurit e mi, dhe të punojmë me sa të kemi mundësi që në ditën e gjykimit të jemi përbri Pejgamberit (a.s.) si vëllezërit e tij!

Të punojmë me sa kemi mundësi për këtë fé të madhnueshme islame, të cilën All-llahu (xh.sh.) e plotësoi për ne dhe për të gjithë racën njerëzore!

Islami, teksa na nxit drejt shembullit të Hz. Ibrahimit (a.s.), e bën këtë sepse dëshiron prej nesh që i riu jonë, prindi i jonë, burri në mesin tonë, gruaja në mesin tonë, vajza, djali, gjithsecili prej nesh të jetë njeri elitar, të jetë njeri me vlera, të jetë njeri që kur të tjerët ta shohin të përmendet Zoti i gjithësisë! Të jetë njeri që kur të tjerët ta shohin, të gëzohen e të ndjejnë qetësi, të ndjejnë kënaqësi, të ndjejnë siguri nga prania e tij në mesin e tyre!

Ky është modeli i besimtarit që kërkon All-llahu (xh.sh.) dhe ky është modeli i shembullit të atyre që ndjekin dhe pasojnë gjurmët e Pejgamberit (a.s.)! Kjo është simbolika e Kurban Bajramit, të cilin jua uroj me zemër në një realitet të çuditshëm dhe ndryshe prej viteve të tjera, por që ju jeni të bindur dhe e dini shumë mirë se nuk ka forcë në botë që e nxjerr besimin nga zemrat e njerëzve!

Ky besim është dhuntia më e madhe e Zotit në jetë, ky besim është dhuntia më e madhe e Krijuesit të gjithësisë! Po të ishte për ne, kushedi si do të kishim qenë!?

Jemi besimtarë sepse All-llahu (xh.sh.) ka vështruar me dritën e mëshirës së Tij në zemrat tona dhe i ka ftuar drejt madhnisë dhe dashnisë së Tij, sikurse na ka udhëzuar në këtë Islam të pastër, të cilin e plotësoi pikërisht në ditën e Arfatit! E bëri këtë ftesë shumëfish më të madhe, me plotësimin dhe bekimin e Tij ndaj kësaj feje të madhnueshme islame.

Në ditën e Arafatit, në atë Haxh të vetëm të Pejgamberit (a.s) i shpalli atë ajet të madh të cilin duhet ta gdhendim në zemër dhe ta kemi bindje të madhe: “Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj!”[4]

Por, a jemi ne muslimanë, pas kësaj thirrje të Zotit?

Të ndjehemi krenarë me fenë tonë, të ndjehemi krenarë në fenë tonë të dashurit e mi, dhe të punojmë me sa të kemi mundësi që në ditën e gjykimit të jemi përbri Pejgamberit (a.s.) si vëllezërit e tij!

Të punojmë me sa kemi mundësi për këtë fé të madhnueshme islame, të cilën All-llahu (xh.sh.) e plotësoi për ne dhe për të gjithë racën njerëzore!

Me zemër të mirë Kurban Bajramin, ju dhe mbarë botës islame! Me zemër të mirë Kurban Bajramin në këtë vend dhe në çdo vend ku lartësohet emri i All-llahut të Madhëruar, të Cilit i lutemi që ta bëjë të sotmen tonë më të mirë se e djeshmja dhe ta bëjë nesërmen më të mirë sesa të sotmen, ta pastrojë këtë vend nga korrupsioni dhe e keqja që ka zgjatur tentakulat e saj për t’ia marrë frymën këtij vendi dhe kësaj shoqërie!

Mirëpo, kjo nuk ndodh veçse me vullnetin e madh të gjithsecilit prej nesh për të kërkuar ndryshimin e së keqes dhe për të çrrënjosur të keqen nga toka e këtij vendi dhe nga realitetet e kësaj shoqërie.

Nëse ne nuk jemi ndryshimi dhe nuk ngrihemi me krejt forcat që ta bëjmë ndryshimin me veprën tonë, me sjelljen tonë, me mendësitë tona, mund të vazhdojmë të flasim me këto retorika edhe 30 vite të tjera, edhe 30 të tjera pas tyre dhe do të vazhdojmë të shohim se si ata që e shkatërruan këtë vend dhe këtë shoqëri, do të vazhdojnë të përdorin situata pas situatash për të vazhduar punën e tyre, sepse ky është fenomeni i kazmave në krejt historinë e njerëzimit!

“Ata që na ndërtonin të djeshmen, na ndërtojnë të sotmen dhe e sotmja u shërben si lavatriçe për të djeshmen!” – thotë një njeri i urtë i trojeve tona shqiptare!

All-llahu ju dashtë dhe ju begatoftë, dhe e bëftë këtë ditë, ditë dëshmie për ne dhe për mbarë ymetin islam!

(Fjala e mbajtur me rastin e Kurban Bajramit, në ceremoninë zyrtare në xhaminë e Fushë Çelës, më 31 korrik 2020)

4. Kur’ani, El-Maide: 3.

NJERIU ËSHTË KRIJUAR PËR TË JETUAR ME DINJITET...

(Reflektim që shoqëron ndërrimin e mbulesës së Qabes së Madhnueshme)

Në këto momente po ndërrohet mbulesa e Qabes së Madhnueshme, në prag të ditës së begatë të Arefatit, që është edhe zemra e adhurimit të Haxhit.

Sa mirë do të ishte që edhe njeriu të përpiqet për të ndërruar jetën e tij, duke u munduar për të ndryshuar drejt më të mirës, besimit e përuljes me zemër e shpirt para duarve të Atij që e krijoi dhe drejt të Cilit do të kthehet!

Shprehja: “Lebbejkall-llahumme lebbejk!”, është fjalia më kuptimplote në jetën e besimtarit! Është madhështor kuptimi i saj: “Të përgjigjem, o All-llah, të përgjigjem!”. Është pa dyshim një moment kthese dhe ndërgjegjësimi, jo thjeshtë një fjalë e thënë, a fjali pas së cilës nuk ka asnjë veprim!

Sonte është natë e madhe! Është nata që i paraprin Ditës së Arefatit, për agjërimin e së cilës, Resulull-llahu (a.s.) thotë se: “... shpresoj në All-llahun, se do të falë gabimet e vitit të shkuar dhe atij që vjen!”, sikurse na ka treguar se: “Nuk ka ndonjë ditë që është më me vlerë tek All-llahu se dita e Arefatit”!

Poashtu, i Dërguari (a.s.) na ka udhëzuar se: “Lutja më e mirë është lutja që bëhet në ditën e Arefatit dhe lutja më e mirë që kam thënë unë dhe të dërguarit para meje, është: La ilahe il-lall-llahu vahdehu la sherike lehu, Lehul-mulku ve lehul-hamdu ve huve ala kul-li shej’in kadir”, që do të thotë: Nuk ka zot tjetër pos All-llahut, i Vetëm i Pashoq, i Tiji është pushteti, Atij i takon falënderimi dhe Ai është k Plotfuqishëm për çdo gjë!

Prandaj, le të bëhemi gati me dhikër e lutje për ta pritur ditën e Arefatit me agjërim dhe shpresë për t’u zhveshur nga gabimet dhe hutimi, nga paragjykimi dhe thashethemet, nga korrupsioni dhe haramet, nga padrejtësia dhe imoraliteti, nga paniku i propagandave të drejtuara për skllavërimin e njeriut dhe zhveshja nga morali i fesë dhe tabanit të humanizmit!

Le të përgatitemi për të shijuar vërshimet e mëshirës dhe faljes, duke dëbuar shejtanin nga jeta, nga mendimet dhe veprimet!

Le të angazhohemi përherë e më shumë me familjen, fëmijët dhe brezin e ri, të cilët janë amanet, që rrezikon të devijojë e të rrëshqasë në humnerat e katrahurave, ku është katandisur sot raca njerëzore!

Është momenti, që teksa ndërrohet mbulesa e Qabes, të kujtojmë se NJERIU është krijuar për të jetuar me dinjitet, jo në hutim e shthurje, larg dritës së besimit e fesë!

Mos të hezitojmë të thërrasim drejt vlerave tona, pa asnjë hezitim e ndrojtje, sepse, sikurse është urdhëruar edhe Resulull-llahu (a.s.) në Kur’anin Famëlartë: “Ti kapu fort pas asaj që të shpallet, sepse ti je në rrugë të drejtë!”.

Me zemër të mirë këtë natë të madhe, ditën që e pason dhe bajram paçin zemrat tona dhe mbarë njerëzimi, në çdo ditë që i japim besën e telbijes Zotit tonë, për të shkuar pas Dritës e Dashnisë së Tij!

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, më 29 korrik 2020

TAPIA E BLERJES SË AJASOFJAS

Gjëja që më ka tërhequr më shumë vëmendjen gjatë studimeve të mia, ka qenë çështja e Ajasofjas, emri i vakëfit, të cilin e ka krijuar Sulltani Muhamedi i Dytë, duke e regjistruar dhe bërë tapinë e Ajasofjas në emër të tij.

Për ata, që nuk e dinë. Sulltani Muhamedi i Dytë njihet me emrin Muhamed El-Fatih. Ka qenë shumë largpamës dhe tepër i zgjuar, gjë për të cilën dëshmon historia dhe armiqtë e tij, përpara se të dëshmojnë të dashurit e tij. Ai mori një hap, ku askush më parë në histori nuk e kishte paraprirë, ku ai, pasi çliroi Kostandinopojën i ofroi priftërinjve blerjen e ndërtesës së Ajasofjas, nga pasuria e tij personale dhe jo nga pasuria e shtetit apo Bejtul-Mal. U arrit kjo blerje (marrëveshje) individuale, pa pasur lidhje me postin e tij shtetëror.

Kjo blerje u dokumentua me kontratë blerje dhe heqje dorë, duke paguar shumën e kërkuar dhe menjëherë (Sulltan Muhamed El-Fatih) krijoi vakëfin (Fondacionin) dhe hoqi dorë prej pronësisë, duke e lënë gjithë atë pronë vakëf dhe me tapi në emër të vakëfit.



Para disa javësh, Turqia u trondit, kur u bë verifikimi i 27 mijë dokumenteve, ku papritur, mes gjithë atyre dokumenteve u gjet edhe dokumenti origjinal i pasurisë (tapia), ku dallohej qartë pronësia e private e vakëfit.

Me këtë rast, të zotët e kësaj pasurie kërkuan me të drejtë përdorimin e kësaj prone, duke ditur se ata janë të zotët e saj. Kërkesa e tyre ishte, që kjo ndërtesë të kthehet në xhami, siç është përdorur që nga momenti i blerjes së saj.

Ajo, që më ka tërhequr vëmendjen, është emri i vakëfit, të cilin e ka krijuar Fatihu (r.a) me emër “Ebul-Fet’h, Sulltan Muhamedi, në origjinalin e aktit të blerjes së tapisë, që është zbuluar së fundmi.

Përktheu nga arabishtja:
Lavdrim Hamja

“KOHA TË PËRMIRËSOJMË CILËSINË E ADHURIMIT DHE MARRËDHËNIEVE NË MES VETE!”

Ditën e xhuma, më 17 korrik 2020, nga minberi i xhamisë së “Dy Vajzave”, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, foli për rëndësinë dhe simbolikën e 10 ditëve të para të muajit të Haxhit, për të cilat është betuar All-llahu në suren El-Fexhr.

Ndër të tjera, Myftiu tha se: “10 ditët e para të Muajit Dhulhixhe, janë një mundësi e re e afrimit me Zotin tonë, e përmirësimit të cilësisë së adhurimit, e pendimit dhe rregullimit të marrëdhënieve familjare, e shtimit të dhikreve dhe agjërimit!”.

Ai theksoi gjithashtu se ky është një moment reflektimi për të kuptuar se, përsa njeriu është korrekt me Zotin e tij dhe, përtej situatave në të cilat kalojmë, All-llahu është me ne, kudo që të jemi e sido që të jemi!

Ai nxiti shtimin e dhikrit dhe

Ky është një moment reflektimi për të kuptuar se, përsa njeriu është korrekt me Zotin e tij dhe, përtej situatave në të cilat kalojmë, All-llahu është me ne, kudo që të jemi e sido që të jemi!

përmirësimin e virdeve ditore, sipas urdhëresave të shumta kur’anore, porosive të Resulull-llahut (a.s.) dhe shpjegimeve të dijetarëve tanë.

Njëkohësisht ftoi besimtarët që periudhën e këtyre ditëve të begata, duke nisur nga data 22 korrik – 30 korrik 2020, ta kalojnë në agjërim e shtim të adhurimit, bamirësisë, korrigjimit të gabimeve, sidomos në familje, farefis e shoqëri.

Poashtu theksoi se agjërimi i ditës së Arefatit për ata që nuk kanë mundësinë e Haxhit, ka shpërblimin e faljes së gabimeve dhe lëshimeve të dy viteve, sikurse na ka udhëzuar i Dërguari i All-llahut (a.s.).

Myftiu tha se, koha është që ne ta shfrytëzojmë këtë mundësi duke dëshmuar përkushtim ndaj betimit që All-llahu i Madhëruar ka bërë për këto ditë e netë në Kur’anin Famëlartë: “Pasha agimin dhe dhjetë netët!”, si dhe haditheve që na mësojnë se nuk ka ditë, në të cilat vepra e mirë të peshojë më rëndë dhe të jetë më e dashur tek All-llahu sesa në këto ditë të bekuara!

I DASHTUN GAZJON..!

(ÇDO FJALË E MIRË PËR TY, NUK ËSHTË KURRË E TEPËRT...)

Herën e kaluar, kur para pak ditësh folëm, ti mezi merrje frymë, megjithatë njerzilleku jot dominoi mbi realitetin... Edhe në atë telefonatë, mirësia e jote e natyrshme qëndroi mbi sprovën tënde; nuk e lejoi të dilte mbi virtytin tënd..!

Ishe i njëjti, si përherë! Ashtu si të njoha që para shumë e shumë vitesh në xhaminë e Tophanës, në aktivitetet e panumërta, përgjatë orëve të gjata të punës së përbashkët për sa e sa botime e punë me dobi për komunitetin, në shërbimet e tua plot pathos, në zellin e papërshkrueshëm në organizimin e djemve, por jo vetëm...

Gjatë këtyre ditëve je përherë e më shumë në hatrin tim, sepse lëngata e jote na ka përfshirë të gjithëve në një vorbull reflektimesh e heshtjeje meditative mbi jetën, besimin, sprovat, miqësinë, vllazninë pa hile e me shumë dedikim zemre (si ajo, që përherë ke rrezatuar dhe vazhdon të na dëshmosh), përkushtimin në familje, atë me amanetin e familjeve shkodrane në Medresenë tonë, me xhematin, me krejt ata që të njohin, e që patjetër do të më miratojnë me një lëvizje koke plot dashamirësi, që përkthehet në një lutje të sinqertë për ty!

Në shoqërinë tonë të brishtë, shembulli jot mbetet modeli i pastërtisë, i moralit, i përkushtimit, i sakrificës në heshtje, i lodhjes me buzagaz, i vullnetarizmit ndërtues, i fjalës së ëmbël, i këmbënguljes për më të mirën!

Sot, të gjithë të përmendim me një lutje, me një shqetësim legjitim, me një kujtim të mirë, me një shpresë që nuk venitet, me një dëshirë të papërshkrueshme që dikush të na lajmërojë: Ia hodhi, elhamdulilah..!

Sot, të gjithë jemi në sprovë me vetveten, kur përmendet rasti yt, krejt jemi të ftuar të lutemi për ty, siç lutet vëllai për vëllanë e tij, pas shpine, duá, të cilës meleku i thotë: Amin!

Sot, krejt jemi në borxh moral e vëllazëror me ty, për çka, çdo gjë që jepet sot për ty, është në realitet një kontribut për të mirën dhe shembulloren në këtë jetë kalimtare, ku përherë e më shumë duhet të japim e të bëjmë për vlerat e shembujt!

Sot... Le të ngelen ca fjalë pa u thënë, sepse çdo fjalë e mirë për ty, nuk është kurrë e tepërt!

All-llahu ta lehtësoftë e qoftë razi me ty, Gazjon Rusi!

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, më 26 korrik 2020

NË RAHMET TË ALL-LLAHUT, I NDERUARI GAZJON RUSI!

Ditën e sotme, më 27 korrik 2020, ndërroi jetë, i nderuari Gazjon Rusi, mësues i përkushtuar i Medresesë "H.Sh.Shamia", prind shembullor dhe vullnetar i kudogjendur me shërbimet e tij ndaj Myftinisë Shkodër dhe komunitetit, veçanërisht në xhaminë e Kuçit.

All-llahu e mëshiroftë dhe e pranoftë veprën dhe kontributin e tij!

I shprehim ngushëllime familjes, kolegëve, miqve dhe nxënësve të tij!

(Myftinia Shkodër)

"KUJTOJE ALLAHUN NË REHATI QË TË TË KUJTOJË NË VËSHTIRËSI"

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kujtoje Allahun në rehati që të të kujtojë në vështirësi”[1], d.m.th kur të jesh në gjendje të mirë, përkushtoju Allahut dhe Ai do të shpëtojë në rastet e vështirësive, halleve, shqetësimeve, etj.

Për ta kuptuar më mirë domethënien e këtij hadithi po sjellim dy shembuj nga Kur’ani dhe një tjetër nga suneti i Pejgamberit (a.s):

Shembulli i Hz. Junusit (a.s)

Dahak bin Kajsi ka thënë: “Kujtojeni Allahun në rehati, ju kujton Ai juve kur jeni në vështirësi[2], sepse Junusi (a.s) e kujtonte Allahun kur ishte në rehati, ndërsa kur qe në vështirësi Allahu (xh.sh) për të tha: “Ai nxitoi drejt një anijeje të mbushur plot e përplot dhe hodhi short (me detarët se kush duhej të hidhej)[3] dhe humbi. Pastaj atë e gëlltiti një balenë, se ai kishte bërë diçka të gabuar, dhe, po të mos ishte nga ata që i luten Allahut, me siguri do të mbetej në barkun e saj deri në Ditën e Ringjalljes.”[4]

Kur Zoti e sprovoi Junusin (a.s), duke e futur në barkun e balenës në thellësinë e oqeaneve, Junusi tha: “Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!”[5], melekët thanë: “O Zot! Një zë i dobët që ne e njohim po vjen nga një vend i panjohur”. Zoti tha: “A nuk e dini se zëri i kujt është ai? Ky është zëri i Junusit. Ai po sprovohet në barkun e balenës”. Atëherë melekët thanë: “O Zot, a nuk do ta shpëtosh robin Tënd që të ka përmend në ditë të mira dhe sot është në ditë të këqija?” Allahu (xh.sh) ua ktheu: “Po, do ta nxjerr. Pasha madhështinë Time, sikur ai të mos kishte qenë nga ata që më kujtonin Mua vazhdimisht, do të kishte qëndruar në barkun e asaj balene deri në ditën e Kiametit”.[6]

Tregimi i Junusit (a.s) përfundon duke i përgëzuar besimtarët: “Ne iu përgjigjëm atij dhe e shpëtuam nga brengosja. Kështu, Ne i shpëtojmë besimtarët”.[7] Ndërsa në rast të kundërt, kemi Faraonin në kohën e Musait (a.s), të cilin Allahu Fuqiplotë e fundosi në det. E, kur ai pa se si përfundoi puna e tij, iu drejtua Allahut me besim dhe bindje tek Ai. Mirëpo Faraoni nuk ishte nga ata që e kishin zërin të njohur tek Allahu dhe kështu Allahu refuzoi t’i përgjigjet thirrjes së tij. Allahu i Lartësuar thotë: “Ne i mbartëm beni izrailit përtej detit dhe Faraoni me ushtrinë e tij i ndoqi ata nga ligësia dhe armiqësia. Por, kur po mbytej, (Faraoni) tha: “Besoj se s’ka Zot tjetër, përveç Atij që i besojnë Bijtë e Izraelit; dhe unë jam ndër muslimanët. Vallë, tani (po beson), ndërkohë që më parë ishe i padëgjueshëm dhe ngatërrestar?!”.[8]

Në një transmetim thuhet: “Kur njeriu lutet në gjendje të mirë ashtu siç lutet në vështirësi, melekët thonë: O Zoti ynë, ne e njohim këtë zë. Ndërsa, kur nuk lutet në gjendje të mirë, por vetëm në vështirësi, melekët thonë: O Zoti ynë, ne nuk e njohim këtë zë”.[9]

Shembulli i Hz. Ejubit (a.s)

Ejubi (a.s) ishte Pejgamber dhe i dashuri i Allahut, të cilit Allahu i kishte dhënë shumë pasuri, familje dhe shumë të mira të tjera, por Allahu më pas deshi ta sprovonte dhe e sprovoi me një sëmundje të rëndë, e cila e bëri të zërë shtratin. Sëmundja i zgjati, të gjithë njerëzit e braktisën nga frika se mos ka ndonjë sëmundje ngjitëse madje e nxorën edhe nga qyteti. Asnjë nga njerëzit dhe miqtë e mëparshëm nuk shkonte ta vizitonte. Personi i vetëm që i qëndroi besnik ishte gruaja e tij. Gruaja detyrohej të punonte me pagesë tek familjet e pasura për të siguruar jetesën. Pas një kohe njerëzit nuk e pranuan as gruan e tij në punë, pasi kishin frikë se mos u ngjiste sëmundjen e Ejubit (a.s). Gruaja e tij u detyrua të shesë edhe gërshetat e saj vetëm e vetëm për të ushqyer burrin e saj.

Kur Ejubi (a.s) pa, se gjendja kishte arritur deri aty sa gruaja të presë gërshetat për t’i shitur, për të siguruar pak ushqim, nuk tha: “O Zot, Ti më ke goditur me fatkeqësi, prandaj më shëro!”, por ai iu drejtua Allahut me edukatën më të lartë: (Kujtoje) Ejubin, kur iu lut Zotit të vet: Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!”.[10] Me t’u lutur, Allahu (xh.sh) ia pranoi lutjen menjëherë: “Ne iu përgjigjem atij, ia larguam mjerimin që kishte dhe ia kthyem familjen të dyfishuar në numër. (Këtë e bëmë) nga mëshira Jonë dhe që të jetë përkujtesë për ata që Na adhurojnë”.[11]

Në suren Enbija përmendet shpëtimi i Ibrahimit nga zjarri, shpëtimi i Lutit nga shoqëria e prishur, shpëtimi i Nuhut nga përmbytja. Përmendet dhurimi i mençurisë dhe diturisë për Davudin dhe Sulejmanin, përmendet shpëtimi i Ejjubit nga fatkeqësia, shpëtimi i Junusit nga brengosja, përmendet dhurimi i djalit për Zekerijan. Pas gjithë këtyre citohet arsyeja e ndihmës hyjnore: “Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me shpresë e frikë dhe ishin të përulur ndaj Nesh”.[12]

Rasti i tre personave që i zuri nata para një shpellë...

Ky hadith tregon për tre personave që i zuri nata në rrugën dhe hynë në shpellë. Një shkëmb u rrokullis nga kodra dhe zuri hyrjen e shpellës. Ata ndërmjetësuan tek Allahu me punë e tyre të mira, që i kishin vepruar në kohën e rehatisë dhe mirësisë. Njëri përmendi respektin e tij ndaj prindërve; i dyti ruajtjen e amanetit duke ia kthyer edhe një herë të zotit; dhe i treti përmendi largimin nga imoraliteti për hir të Allahut, pasi i kishte të gjitha mundësitë për ta kryer atë vepër. Allahu ua largoi vështirësinë dhe shkëmbi u rrokullis derisa ata dolën nga shpella.[13]

Besimtari gjithnjë i drejtohet Allahut, por strehimi dhe përgjërimi tek Ai në momente të vështira të jetës është qetësi e mendjes dhe rrugëzgjidhje e problemit. Një nga mënyrat për t’iu afruar Allahut dhe për të ndërmjetësuar tek Ai, gjatë lutjes, është edhe puna (vepra) e mirë. Vepra e mirë nuk humbet, vlera e saj shfaqet në momente të vështira. Allahu i pranon veprat e sinqerta dhe shpërblen për to në dynja dhe ahiret. Ky hadith na motivon për të qenë të sinqertë dhe për të bërë vepra të mira. Allahu i Madhëruar thotë: “Ai që i frikësohet Allahut, Ai do t’i gjejë atij rrugëdalje (nga çdo vështirësi)”.[14]

Allahu na bëftë nga ata që kur janë në vështirësi e kanë Allahun pranë dhe u përgjigjet lutjeve të tyre!

1. Pjesë e hadithit të gjatë të Abdullah bin Abbasit (r.a) transmetuar nga Hakimi, Taberaniu dhe Bejhakiu.
2. Shih: *Nur El-Iktibas*, f. 72.
3. Sipas komentuesve të Kuranit (konkretisht Ibn Kethirit), për shkak të ngarkesës së madhe, anija ishte gati të mbytej, prandaj detarët ranë dakord ta bëjnë me short se kush do të hidhej nga anija, në mënyrë që pesha e saj të lehtësohej e të shpëtonin nga mbytja.
4. Kur’ani, Es-Saffat: 140-144.
5. Kur’ani, El-Enbija: 87.
6. Shih: *Tefsir Taberij*, 17/81.
7. Kur’ani, El-Enbija: 88.
8. Kur'ani, Junus: 90-91.
9. Këtë transmetim e ka përmendur Ibn Rexheb El-Habelij tek libri i tij “Xhamiul Ulumi vel Hikem”, ndërsa, kuptimi i kësaj thënie ka ardhur në hadithin e Enes ibn Malikut të transmetuar nga Taberani.
10. Kur’ani, El-Enbija: 83.
11. Kur’ani, El-Enbija: 84.
12. Kur’ani, El-Enbija: 90.
13. Buhariu dhe Muslimi.
14. Kur’ani, Et-Talak: 2.

SULMI NDAJ IMAM BUHARIUT ËSHTË SULM NDAJ ISLAMIT NË PËRGJITHËSI



Prof. Dr. **Ahmed M. Abdulkerim**

Që nga momenti kur filloi Shpallja e Kur'anit, i Dërguari i Allahut, Muhammedi (s.a.v.s.), nisi komentimin dhe interpretimin Fjalës së Zotit, në mënyrë që pjesëtarëve të ymetit të tij, t'ju bëj sa më të qarta dhe më të kuptueshme dispozitat fetare, si dhe t'ju lehtësojë e sqarojë njerëzve çështjet e fesë së tyre. Më pas, këtë amanet, e morën mbi supet e veta sahabët e ndershëm të Pejgamberit (a.s.) dhe për të mbrojtur Sunnetin (si burim i dytë i Sheriatit), ata ndërmorën dy kritere:

1. Hadithet e Profetit (a.s.) t'i përcjellin tek të tjerët, pasi Pejgamberi a.s. kishte thënë: "Allahu e hijeshoftë atë njeri, i cili dëgjon fjalët e mia, i mban mend ato dhe ua përcjell të tjerëve ashtu siç i ka dëgjuar", dhe

2. Gjatë shënimit dhe transmetimit të haditheve të jenë shumë të kujdesshëm dhe tepër të përpiktë, pasi i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) kishte thënë: "Kush gënjen për mua qëllimisht, le t'ia përgatisë vetes vendin në zjarr (xhehenem)."

Pra, bazuar në këto hadithe, sahabët e nderuar vendosën këto dy rregulla: "Thëniet profetike domosdoshmërisht t'i përcjellin tek të tjerët dhe ndalohet rreptësisht të gënjehet apo ndryshohet diçka sado e vogël në adresë të Pejgamberit (a.s.)." Kështu, sahabët (r.a.), me kujdes shumë të madh e ruajtën hadithin profetik duke iu përmbajtur fuqishëm këtyre dy parimeve, derisa Sunneti (Hadithi) u përcoll në formën më të besueshme tek gjenerata e tabiinëve, e pastaj tek tabi-tabiinët e kështu me radhë brez pas brezi deri në ditët e sotme.

Mirëpo, ne i gjejmë armiqtë e Sunnetit të Profetit në të gjitha periudhat kohore, të cilët thërrasin dhe përpiqen vazhdimisht për të asgjësuar dhe shtrembëruar Sunnetin, në mënyrë që të fusin dyshim dhe pasiguri tek njerëzit.

Kur të huajt okupuan dhe kolonizuan vendet islame që nga India e deri në Oqeanin Atlantik, ishin të etur për të shkatërruar trashëgiminë islame. Kështu filluan me mbledhjen e librave të hadithit dhe tefsirit nga xhamitë, shkollat dhe bibliotekat të cilat më pas i çuan në vendet e tyre. Shumë kopje origjinale të librave tanë janë ende të pranishme në bibliotekat e Evropës. Për shembull, kopja origjinale e veprës "Përmbledhja e haditheve të Imam Tirmidhiut" edhe sot e kësaj dite gjendet në Bibliotekën Kombëtare në Paris, e cila është marrë nga Egjipti në ditët e Napoleonit, atëkohë kur Franca kishte pushtuar Egjiptin. Po ashtu ka edhe dorëshkrime të tjera që gjenden në bibliotekat e Parisit, Londrës, Romës, Berlinit etj. Pra, ajo që ndodhi në Egjipt ndodhi edhe në të gjitha vendet e botës islame që ishin të okupuara.

Kurse sa i pëket sulmit ndaj imam Buhariut, s'ka dyshim se është pjesë



e sulmit ndaj Akides së pastër dhe Sheriatit Islam. Imam Buhariu (Allahu qoftë i kënaqur me të), e nis veprën e tij të famshme "El-Xhamius-Sahih" me librin që flet për fillimin e Vahjit (Shpalljes), e pastaj menjëherë me librin që flet për Besimin (Imanin) dhe në fund librin për monoteizmin (Teuhidin), ndërsa midis këtyre librave (kapitujve) ka shënuar dhe përzgjedhur hadithe të tjera autentike që flasin për bazat e adhurimeve (ibadeteve), për marrëdhëniet ndërnjerëzore (muamelat), për rregullat dhe dispozitat e ndryshme fetare, etj. Andaj sulmi ndaj Sahihut të Buhariut është, në të vërtetë sulm ndaj Islamit në përgjithësi.

S'ka dyshim se Imam Buhariu zë një pozitë të lartë në zemrën dhe shpirtin e çdo besimtari dhe kurdo që dikush e përmend ndonjë hadith dhe thotë se ai hadith ndodhet në Sahihun e Buhariut, menjëherë zemra e muslimanit qetësohet dhe rehatohet e kjo i jep një ndjenjë sigurie.

Gjithashtu shumica e haditheve që flasin për namazin, agjërimin, zekatin, haxhin, lutjet dhe ibadetet tjera ndodhen pikërisht në Sahihun e Buhariut. Prandaj nëse vihet në dyshim Buhariu, sigurisht se muslimani do të ndjejë pasiguri dhe lëkundje në akiden (besimin) e tij, e ky zatën është edhe qëllimi dhe synimi i armiqëve të Islamit, që përmes sulmit dhe denigrimit ndaj imam Buhariut ta sulmojnë dhe denigrojnë Islamin në përgjithësi.

Muslimanët duhet të jenë të vetëdijshëm se të gjitha akuzat dhe dyshimet ndaj Imam Buhariut, refuzohen kategorikisht nga ulematë, studiuesit dhe ekspertët e fushës së hadithit përgjatë historisë, dhe të gjitha argumentet e tyre kundër Buhariut janë të pabaza, iluzione dhe të papranueshme. Ata që flasin kundër Buhariut dhe Sahihut të tij, nuk kanë lidhje me Shkencën e Hadithit, por fatkeqësisht shfrytëzojnë injorancën e atyrë që i dëgjojnë.

PS: Autori është muhaddith i spikatur (ekspert i shkencës së hadithit) dhe anëtar i organit më të lart të dijetarëve të Ez'heri Sherifit.

Nga arabishtja:
Enes Koshi

Imam, Rebstein - 11.07.2020

POETËT OSMANË TË VILAJETIT TE SHKODRËS

Një thesar i zbuluar në botën e letërsisë Osmane

ALİ EMÎRÎ EFENDİ*
(1857-1923)

Në fillim të vitit 1314/1896 kryeja detyrën e defterdarit[1] në vilajetin e Erzurumit. Papritmas, nga Stambolli më vjen një telegraf, ku thuhet që tashmë isha emëruar si kryeinspektor i financave në vilajetin e Shkodrës dhe për këtë arsye duhet të gjendej një person që do të më zëvendësonte për disa kohë në detyrën aktuale.

Brenda disa ditëve u nisa nga Erzurumi për në Stamboll e që aty vazhdova rrugën për në Janinë. Pas njëfarë qëndrimi në Janinë, u nisa për në Shkodër duke kaluar nga Leskoviku, Përmeti, Berati, Lushnja, Kavaja dhe në fund në Durrës. Që aty nëpërmjet detit udhëtova për në Shkodër. Gjëja e parë që vura re te ata njerëz ishte zgjuarsia, aftësia, besnikëria ndaj shtetit Osman dhe gjithashtu të qenët mjaft trima. Por as ata nuk më thanë ndonjë gjë dhe as vetë nuk kuptova që aty kishte prezencë dhe gjurmë të letërsisë Osmane. Pasi qëndrova në Shkodër rreth dy-tre muaj, u ktheva përsëri me detyrë në Janinë.

Pas njëfarë kohe të qëndrimit në Janinë m'u desh të kthehem edhe njëherë në Shkodër. Por kësaj here qe caktim prej Zotit, që një grup hoxhallarësh më erdhën për vizitë në zyrë. Mirëseardhjen ma bënë në arabisht. Unë, i çuditur prej kësaj, i pyeta se nga e kishin mësuar arabishten. Ata mu përgjigjën që përveç arabishtes njohin turqishten, madje edhe persishten. Edhe baballarët dhe gjyshërit tanë i kanë njohur këto gjuhë, më thanë. Mua m'u shtua akoma më shumë mahnitja dhe fillova të flas me ta rreth letërsisë Osmane, meqë edhe vetë jam merakli i asaj fushe. Ata më treguan se në mesin e të parëve të tyre ka patur shumë poetë dhe letrarë, madje disa prej tyre kanë shkruar libra poezish (divane). Ajo që më habiti ishte fakti se unë, edhe pse kisha lexuar dhe studiuar shumë libra dhe biografi rreth poetëve Osmanë, përveç atyre poetëve me origjinë shqiptare që njihen, nuk kisha hasur në ndonjë emër poeti shqiptar që ka shkruar dhe ka lënë libra letërsie, dhe që në të njëjtën kohë nuk ka dalë nga kufijtë e Shkodrës ose ka dalë vetëm për një kohë të caktuar.

Pasi regjistrova emrat e autorëve që ata më përmendën, iu kërkova nëse kishin edhe biografitë e tyre dhe nëse ekzistonte ndonjë libër a dorëshkrim i mbetur. Ata më befasuan, sepse filluan të sjellin para meje, jo një e dy por një duzinë me dorëshkrime dhe libra me shumë kapituj (mexhmua) të shkruar nga të parët e tyre.

Kur u përhap lajmi në Shkodër se unë kisha interes në diçka të tillë, filluan të më vijnë edhe njerëz, të cilët edhe pse vetë nuk dinin shkrim e lexim, me duart plot libra më thoshin: "Zotëri,

> **Mes shqiptarëve ka patur aq shumë autorë librash poezie, aq shumë fjalë me vlerë të thëna e aq shumë trajtesa me karakter shoqëror janë bërë prej tyre, saqë mund të them se shqiptarët, treguan se edhe në këtë fushë janë surprizues. Ata edhe në këtë lëmi ishin të aftë dhe aspak më të vonuar se vilajetet tjera Osmane të njohura me poetët dhe shkrimtarët e tyre.**

edhe gjyshi im ka qenë dijetar dhe poet. Urdhëro, merre edhe librin e tij. Lexojeni dhe regjistrojeni atë. Inshallah kjo bëhet shkak që edhe shpirtit të tij t'i shkojë një rahmet."

Dhoma ime u kthye tashmë në një bibliotekë. Meqë kisha vetëm një muaj kohë që më kishte mbetur në Shkodër, vazhdova të punoja me këto libra ditën dhe natën. Disa prej tyre i sillnin librat dhe më thoshin: "Merrini zotëri. Merrini librat dhe mbajini. Mos na i ktheni më se i kemi kopjet e tyre". Kurse unë u thosha: "Unë do i marr, por me një kusht. Përcaktoni një çmim, ashtu do i marr." Por ata njerëz fisnikë nuk pranuan asnjëherë që kundrejt librave të marrin ndonjë çmim. Sado që u mundova t'u jap diçka, nuk arrita dot t'ua ndryshoj mendjen. Por edhe unë nga ana tjetër, vetëm sa i kopjova librat dhe origjinalët ua ktheva atyre. Ah, ah! Me siguri që disa njerëz, kur të lexojnë këto rreshta nuk do duan t'i besojnë fjalëve të mia. Por, këta që nuk besojnë, sikur vetëm njëherë të kishin mundësi të shkonin atje e t'i njihnin nga afër këta njerëz të sinqertë e këto vende, pastaj le të thonë çfarë të duan.

Ekspertë të fushës më thanë që poetët dhe letrarët do t'i gjeja jo vetëm në Shkodër, por edhe në Krujë, Tiranë, Kavajë etj. Dhe ashtu ishte në fakt. Për fat të keq, këto thesare pata mundësi t'i gjej vetëm në vizitën time të dytë në Shkodër. Sikur ta dija edhe herën e parë diçka të tillë, ose po të kisha mundësi të shkoja edhe njëherë tjetër atje, me siguri që do gjeja shumë gjëra tjera interesante.

Sasia që gjeta nga këto informacione, ishte një rezultat i një qëndrimi vetëm 3 mujor në Shkodër. Megjithatë, brenda kësaj kohe të shkurtër, u binda që mes shqiptarëve ka patur aq shumë autorë librash poezie, aq shumë fjalë me vlerë të thëna e aq shumë trajtesa me karakter shoqëror janë bërë prej tyre, saqë mund të them se shqiptarët, treguan se edhe në këtë fushë janë surprizues. Ata edhe në këtë lëmi ishin të aftë dhe aspak më të vonuar se vilajetet tjera Osmane të njohura me poetët dhe shkrimtarët e tyre. Pikërisht për atë se vizita e Shkodrës mua më surprizoi për mirë, e pashë të përshtatshme që librin tim ta titulloj: "Poetët Osmanë të vilajetit të Shkodrës - Një thesar i sapo zbuluar në botën e letërsisë Osmane".

Përgatiti: **Dr. Ferid Piku**

- Ky material është marrë nga parathënia e punimit me titull "İşkodra Vilayeti Osmanlı Şairleri", përgatitur nga Hakan Karateke dhe botuar në vitin 2018 nga Ministria e Kulturës dhe Turizmit së Republikës së Turqisë.

---

1. Defterdari ishte në rolin e drejtorit të lartë të financave.

* Ali Emiri (1857-1923) me origjinë nga Dijarbekiri, ka qenë historian dhe koleksionist librash. Ai njihet ndryshe si themeluesi i Bibliotekës së quajtur *Millet Kutuphanesi*. Është autor i disa artikujve dhe botues i disa gazetave dhe revistave.

LIBIA
(SHTETI ME 41.5 MILIARDË FUÇI NAFTE REZERVA)

Shteti i Libisë është një vend arab që ndodhet në Afrikën e Veriut, në bregdetin jugor të Detit Mesdhe. Ky vend kufizohet me Egjiptin në lindje, në juglindje me Sudanin, në jug me Çadin dhe Nigerinë, në perëndim me Algjerinë dhe në veriperëndim me Tunizinë.

Libia ka një popullsi prej 6.876.501 banorësh (sipas worlmeter, 2020) [1] dhe një sipërfaqe prej 1.800.000 km2. Popullsia e Libisë konsiderohet

të jetë mjaft e vogël në krahasim me sipërfaqen e vendit, dhe renditet shteti i gjashtëmbëdhjetë në botë për sa i përket sipërfaqes. Gjithashtu Libia ka vijën bregdetare më të gjatë midis vendeve që kufizojnë Detin Mesdhe, gjatësi e cila shkon në rreth 2000 km.

Libia përbëhet nga tre rajone kryesore: Tripoli, Berka dhe Fezan.

Tripoli, qyteti më i madh i Libisë, është kryeqyteti i vendit.

Emrin e vet shteti i Libisë e ka marrë nga fisi Libo, një fis i cili që në kohë të lashta kanë banuar në veri të kontinentit Afrikan, në zonën midis Egjiptit dhe Tunizisë.

KLIMA

Klima e shtetit të Libisë është e moderuar në stinët e vjeshtës dhe pranverës, kurse në verë është e nxehtë, e në dimër relativisht e ftohtë. Libia ka një klimë të larmishme, ku në zonën e bregut të Mesdheut dominon klima mesdhetare, në pjesën qendrore të vendit dominon një klimë gjysmë-shkretëtire, ndërsa në pjesët jugore mbizotëron klima e shkretëtirës, e cila karakterizohet nga dimri shumë i ftohtë dhe vera shumë e nxehtë, me reshje të pakta shiu. Libia karakterizohet nga mungesa e burimeve ujore sipërfaqësore për shkak të sasisë së ulët të reshjeve dhe formimit të saj gjeologjik, kështu që vendi mbështetet kryesisht tek ujërat nëntokësore (me 95.6%).

GJUHA

Arabishtja është gjuha zyrtare dhe mbizotëruese në vend, gjuhë të cilën popullsia libiane e flet sipas dialektit të saj libian dhe që ndryshon nga një rajon në tjetrin, për shkak të hapësirës së gjerë gjeografike të vendit. Gjithashtu, gjuha angleze përdoret kryesisht në qytetet libiane, në arsimin universitar, sidomos në fakultetet e shkencave të aplikuara, siç përdoret edhe në shumë kompani të huaja të gjendura në vend. Ndërsa fshatrat libiane, ato ende e ruajnë identitetin e tyre origjinal; ata akoma vazhdojnë të flasin gjuhën amazigije, e quajtur ndryshe edhe si gjuha berbere ose mureane. Në vitet shtatëdhjetë, pati një përhapje të frëngjishtes dhe italishtes, dhe si rezultat, ndër brezat e vjetër ka akoma nga ata të cilët ende i flasin këto gjuhë.[2]

EKONOMIA

Libia është një vend i pasur me burime natyrore, ku nafta dhe gazi natyror konsiderohen burimet kryesore të të ardhurave në vend. Rezervat e saj të naftës arrijnë në rreth 41.5 miliardë fuçi. Shteti i Libisë konsiderohet një nga vendet më të pasura në rezervat e naftës dhe zë vendin e nëntë midis vendeve më të mëdha në botë për sa i përket rezervave të mëdha të naftës. Gjithashtu, vendi është i njohur për kultivimin e një numri kulturash bujqësore, si gruri, perimet, frutat, domatet dhe elbi. Ndërsa për sa i përket industrisë, ndër prodhimet më të rëndësishme industriale atje janë materialet e ndërtimit dhe çimentoja, soda kaustike, plehrat e uresë, dhe industritë petrokimike.

FEJA

Libia është një shtet homogjen për sa i përket fesë, me 97% të popullsisë së saj myslimanë dhe vetëm 3% i përkasin feve të tjera, shumica e të cilëve janë të huaj që nuk janë banorë të përhershëm.

SI HYRI LIBIA NË ISLAM

Një grup libianësh u rebeluan ndaj regjimit të perandorisë Bizantine dhe dolën në zonën e Egjiptit, me qëllimin të takoheshin me prijësin e ushtrive muslimane atje, me Amr ibnul-As, Zoti qoftë i kënaqur prej tij (ai asokohe ishte edhe mëkëmbësi i Egjiptit). Pasi u takuan me të, ata deklaruan pranimin e fesë islame dhe mbështetjen e tyre për muslimanët.

Amr ibnul-As planifikoi të përdorte një strategji mbrojtëse për Egjiptin, për sa i përkiste anës perëndimore të vendit, zonë e cila kërcënohej nga romakët që ishin të vendosur në zonën Berka dhe

Tripoli, kryeqyteti i Libisë (para shkatërrimit)

Tripoli. Gjithashtu, në vitin 22h (642) ai vendosi të dërgonte Ukbe ibn Nafi' (r.a) në një ekspeditë hulumtuese, si pararendëse të pushtimit të viseve perëndimore. Ukbe ibn Nafi' (r.a) arriti ta merrte qytetin Zueila pa luftë.

Në të njëjtin vit, Amr ibnul-As u nis vetë nga Egjipti, derisa mbërriti në Berka, ku banonin disa nga degët e fiseve Latvana dhe Zevaga. Këto fise ishin të mllefosur ndaj bizantinëve, për shkak të padrejtësive dhe abuzimit që u bënin, dhe për shkak të taksave të rënda që u kishin vënë. Kështu që ata ranë dakord t'u paguanin xhizjen muslimanëve, në këmbim të mbrojtjes nga romakët.

Në të njëjtin vit, Amr ibnul-As mbërriti në qytetin Exhdabije të Libisë, dhe e mori pa luftë atë, me kusht që banorët e tij të paguanin pesë mijë dinarë, por ata nuk vazhduan gjatë ta paguanin xhizjen, pasi shumica e tyre pranuan Islamin, për shkak të drejtësisë, ndershmërisë, dhe dëlirësisë së moralit që kishin parë tek ushtarët muslimanë, gjë të cilën nuk e kishin hasur asnjëherë më parë në ushtritë e perandorive të mëparshme.[3]

Brenda pak muajsh, Amr ibnul-As arriti të merrte dy të tretat e Libisë. Tani para tij qëndronte Tripoli, qytet i ndërtuar në brigjet e detit Mesdhe. Në vitin 643, ai e rrethoi qytetin dhe pas një muaji rrethim, arriti ta merrte edhe atë. Më pas kishte mbetur vetëm qyteti i Sabratës, e pasi e mori edhe atë, i gjithë bregdeti i Libisë hyri nën kontrollin e muslimanëve.

Kështu, deri në vitin 23 të hixhretit, Amr ibnul-As e zotëronte tërë vendin libian me tre provincat e tij: Sirenaikën në lindje, Fezan-in në jug, Tripolin dhe Sabratën së bashku me rrethinat e tyre, në perëndim.[4]

NJË KRONOLOGJI E PËRMBLEDHUR E HISTORISË SË LIBISË

Shekulli 7-të (p.e.s) - Fenikasit u vendosën në Tripolitania (në Libinë perëndimore), e cila deri në këtë kohë ishte e populluar nga Berberët.

Shekulli 4 (p.e.s) - Grekët kolonizojnë Sirenaikën, në lindje të vendit, zonë të cilën e ata e quajnin Libi.

Viti 74 (p.e.s) - Romakët pushtojnë Libinë.

Viti 643 (e.j) - Muslimanët e morën Libinë dhe përhapin Islamin.

Shekulli i 16-të - Libia bëhet pjesë e Perandorisë Osmane, e cila i bashkoi provincat e Tripolitanisë, Sirenaikës dhe Fezzan-it, në një regjencë të vetme, në Tripoli.

Vitet 1911-12 - Italia e merr Libinë nga Osmanët. Omer Mukhtari fillon kryengritjen 20-vjeçare kundër sundimit italian.

Viti 1942 - Aleatët i largojnë italianët nga Libia, e cila më pas ndahet midis francezëve dhe britanikëve.

Viti 1951 - Libia bëhet e pavarur, nën mbretin Idris Sanusi.

Viti 1969 - Muammar Gadafi, 27 vjeç, e largon mbretin nëpërmjet një grushti shteti ushtarak, pa gjak.

Viti 1992 – OKB-ja vendos sanksione ndaj Libisë për shkak të bombardimit të një aeroplani Panama nga ana e libianëve, mbi qytetin skocez të Lockerbie, në dhjetor të vitit 1988.

Viti 2011 - Protestat e dhunshme shpërthejnë në Bengazi dhe përhapen edhe në qytete të tjera. Kjo çon në një luftë civile, në ndërhyrje të huaj dhe përfundimisht në rrëzimin dhe vrasjen e Gadafit.

Viti 2016 - Pas viteve të konfliktit, një qeveri e re e mbështetur nga OKB-ja, instalohet në Tripoli. Kjo qeveri hasi në kundërshtimin e dy qeverive rivale dhe të një morie militantësh.[5]

Sot, Libia po kalon një periudhë të vështirë me konflikte dhe destabilitet. Allahut i lutemi të zbresë paqen e Tij mbi atë vend dhe mbi gjithë njerëzimin! Amin!

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

1. https://www.worldometers.info/world-population/libya-population
2. https://www.lcrsss.ly/about-libya.htmll
3. https://lite.islamstory.com/ar/artical/4640
4. https://www.aljazeera.net/midan/intellect/history/2020/7/3
5. https://www.bbc.com/news/world-africa-13754897

AJASOFJA ËSHTË ÇËSHTJE SOVRANITETI...

Sulltani i 7-të i Perandorisë Osmane, Fatih Mehmedi i II-të hyri si ngadhënjimtar në Stamboll më 29 maj të vitit 1453. Ai e ktheu Ajasofjen në xhami duke falur namazin e parë të xhumasë më 1 Qershor 1453. Pasi e bleu nga pasuria vetjake këtë xhami, e ktheu në vakuf dhe la një vakëfname (dokument a tapi e vakëfit) prej 66.5 metra të shkruar në lëkurë gazele, ku me largpamësinë e tij kërkoi që Ajasofja të mbetej xhami deri në fund të ekzistencës së kësaj bote.

Ajasofja ka shërbyer si xhami për 481 vjet ndërsa në 86 vitet e fundit ka shërbyer si muze pas një vendimi të Këshillit të Ministrave të datës 2 nëntor 1934. Ndërkohë, më 10 korrik 2020 me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe me miratimin e presidentit Erdogan, Ajasofja nga muze, u kthye në xhami. Aktualisht Turqia ka rreth 84 700 xhami. Në vend të parë renditet Stambolli me 3 499 xhami. Lind pyetja: Përse ishte e nevojshme hapja e Ajasofjes mes kaq shumë xhamive të tjera?

Është i ditur parimi sipas së cilit, si të ndërtohet pyetja ashtu merret edhe përgjigjja. Ajosofja nuk është thjesht një xhami që rrit me 1 më tepër numrin total të mijëra xhamive në Stamboll. Ajasofja është një simbol i pavarësisë dhe sovranitetit të shtetit turk. Ky lajm është bërë çështje e ditës në shtypin botëror nga SHBA-ja në Rusi, nga Greqia në Palestinë... Ka nga ata që e kritikojnë, kërcënojnë, madje edhe mallkojnë Turqinë për këtë vendim. UNESCO (Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara) deklaroi se statusi i Ajasofjes, e cila është në listën e trashëgimisë botërore që nga viti 1985, do të rishikohet në mbledhjen e ardhshme. Ka nga ata që frikësohen se UNESCO do e përjashtojë Ajasofjen nga lista e trashëgimisë botërore dhe nuk do e njohë më në këtë listë. Qesharake! Ajasofja është shumë më e "njohur" se UNESCO-ja (themeluar më 16 nëntor 1945) dhe se vetë OKB-ja (themeluar më 24 tetor 1945). OKB-ja vetëm se e ka nderuar veten me marrjen e Ajasofjes në listën e trashëgimisë kulturore të UNESCO-s dhe jo e kundërta. Nuk ka asnjë organizatë apo institucion që mund t'ia rrisë apo pakësojë vlerën Ajasofjes.

Ndoshta pyetja mund të drejtohej ndryshe: Pse pikërisht më 10 Korrik 2020 Republika e Turqisë vendosi të hedhë një hap të tillë?

Ishte i njëjti shtet që vendosi kthimin në muze. Është po ky shtet që vendosi kthimin në xhami. Ngjarjet zhvillohen sipas dinamikës së kohës. Me ndryshimin e dinamikave ndryshojnë edhe vendimet. Ka ardhur koha që Turqia si shtet të jetë zot i fjalës dhe sovran i tokës së vet. Kush mendon se politika e sanksioneve dhe kushtëzimeve do i presë rrugën apo do trembë Turqinë në hapat e saj, ose nuk e njeh aspak gjeopolitikën e kohës ose përdor taktikën e ngritjes së zërit për të mundur fjalën.

Por e vërteta është se tashmë kemi një Turqi që dita ditës po shkëput vargonjtë e ndryshkur që s'kanë bërë gjë tjetër vetëm se kanë munduar lokomotivën. Gjatë 18 viteve të fundit, "jo vetëm që është gjuajtur shejtani me gurë, por është bërë edhe tavaf..." Kthimi i Ajasofjes nga një vend, në të cilin hyhej me para dhe me këpucë, në një vend ku hyhet falas dhe me abdes është në vetvete një simbol, është simboli i sovranitetit të një shteti legjitim dhe me një taban kulturor e historik mijëravjeçar.

Si përfundim, ata që vajtojnë zhbërjen e një muzeu në emër të qytetërimit dhe mbrojtjes së vlerave kulturore botërore, të ndalen e të mendojnë pak, që Osmanët nuk e shkatërruan, rrënuan dhe plaçkitën "Shën Sofinë", por e rimëkëmbën, e fuqizuan dhe e kthyen atë nga një godinë të vetme, në një kompleks të mirëfilltë me bibliotekë, medrese, hamam, shatërvan, imaret`hane (organizëm bamirësie ku u shpërndahej ushqim të varfëra dhe nevojtarëve.) etj. Historia ka dështuar se perandori të ndryshme (të ashtuquajtura qytetërime) kanë dashur të tregojnë se janë të zotët e tokave të pushtuara duke djegur, plaçkitur, rrënuar dhe përdhosur vepra të pazëvendësueshme të artit dhe kulturës botërore. Dhe e kanë bërë!

Nëse sot Ajasofja është akoma në këmbë me gjithë madhështinë dhe hijeshinë e saj, kjo falë largpamësisë dhe një këndvështrimi unik të osmanëve të asaj kohe dhe trashëgimtarëve të tyre. Ato që sot çirren se u iku nga duart një muze, mund të lobojnë për Katedralen e Kordobës, por nuk do e bëjnë kurrë, sepse çështja nuk është xhamia apo kisha, çështja është sovraniteti...

Rrugë të mbarë Turqi!

Msc. **Elona Sytari**



PASI E BLEU NGA PASURIA VETJAKE KËTË XHAMI, E KTHEU NË VAKUF DHE LA NJË VAKËFNAME (*DOKUMENT A TAPI E VAKËFIT*) PREJ 66.5 METRA TË SHKRUAR NË LËKURË GAZELE...

MASAKRA E SREBENICËS, SKENA DHE EGËRSI TË PAIMAGJINUESHME

"Provat e paraqitura nga Prokurori përshkruajnë skena dhe egërsi të paimagjinueshme: mijëra burra të ekzekutuar e të varrosur në varr masiv, qindra burra të varrosur për së gjalli, gra e burra të gjymtuar e të masakruar, fëmijë të vrarë para syve të nënave të tyre, një gjysh që u detyrua të hajë mëlçinë e nipit të tij. Këto janë me të vërtetë skena nga ferri, të shkruara në faqet më të errëta të historisë njerëzore".

Kjo është fjala e Fouad Riad - Gjyqtar në Tribunalin e Hagës me rastin e konfirmimit të aktakuzës ndaj Mladic dhe Karadzic për Srebrenicën në nëntor 1995.

Sot bëhen 25 vite prej ditës kur ndodhi masakra që tronditi botën: gjenocidi në Srebrenicë. Më shumë se 8,000 burra dhe djem myslimanë të Bosnjës u vranë më 10 dhe 11 korrik 1995, pasi Ushtria Serbe e Bosnjës sulmoi Srebrenicën.

Edhe pse më shumë se 7,000 trupa të pajetë janë gjetur dhe identifikuar, sot e kësaj dite më shumë se 1,000 njerëz akoma mungojnë, dhe janë të paidentifikuar.

Bosnja përballet ende me një numër masiv rastesh të pazgjidhura për këtë masakër. Përballet me persona që e mohojnë ekzistimin e gjenocidit të kryer atje.

Por ajo çka ka ndodhur në Srebrenicë është gjenocid. Jo vetëm sepse e ka parë gjithë bota, por këtë e ka vërtetuar edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND).

Fatkeqësisht, GjND e kualifikoi si gjenocid vetëm krimin që ka ndodhë në Srebrenicë e jo krimet që kanë ndodhë në tërë Bosnje dhe Hercegovinën (BeH), praktikisht duke konsideruar 'gjenocidin komunal'. Të ekzekutuarit në Srebrenicë ishin nga e gjithë BeH sepse Srebrenica ishte zonë e mbrojtur nga OKB-ja. Serbia nuk u bë përgjegjëse për kryerjen e gjenocidit, por përgjegjëse që nuk e ndaloi gjenocidin, thua se trupat që e kryen gjenocidin kanë shkuar në BeH nga shtete të tjera e Serbia nuk i ndaloi!

Nga Qendra për të Drejtën Humanitare e udhëhequr nga Natasa Kandic, e dimë se afër 4,000 oficerë të armatës jugosllave nga Serbia luftuan kundër boshnjakëve në BeH dhe janë paguar nga Serbia. Po ashtu i gjithë armatimi dhe uniformat iu shkonin nga Serbia. Prej 25,000 serbëve që u vranë në Bosnje, as 1/5 nuk ishin civilë. Serbia është përgjegjëse sepse në fund të fundit Marrëveshjen e Dejtonit e ka nënshkruar Presidenti i Serbisë Miloseviç.

Prandaj, ende nuk ka drejtësi e paqe për Srebrenicën dhe BeH. Prandaj, kjo mizori peshon rëndë në ndërgjegjen ndërkombëtare edhe çerek shekulli më vonë.

Albin Kurti, *kryministër i Kosovës, shkurt - qershor 2020.*
(Nga postimi në facebook, 11.06.2020)

I DËRGUARI I ALL-LLAHUT (A.S) KA THËNË:

"All-llahu e ka krijuar mëshirën njëqind pjesë, një pjesë e ka vendosur në mesin e krijesave të Tij; me të mëshirohen..!"

(Muslimi nga Ebu Hurejra)

"I dëshpëruar dhe i humbuar është ai njeri, në zemrën e të cilit, All-llahu nuk ka vendosur mëshirë për njerëzit!"

(Ebu Nuajmi dhe Ibn Asakir, nga Amr ibn Habib)

MEJTEPI I IM... XHAMIA E FSHATIT GURI I ZI

Pak histori:

- Xhamia Gur i Zi, ndodhet në Njësinë Administrative Gur i Zi, zona Shkodër.

- Fshati Gur i Zi përbëhet prej rreth 210 familje. Fiset më të njohura janë: Dyli, Selimi, Ymeri, Velia, Haxhia, Lahi, etj.

- Xhamia e re, Gur i Zi është ndërtuar dhe ka filluar të funksionojë që nga viti 2002. Përpara saj ka funksionuar për adhurim xhamia e vjetër, e cila është hapur rreth viteve 1992.

- Në xhaminë e re nga viti 2002 deri më sot kanë shërbyer imamë dhe mësues të mejtepeve: Bujar Ymeri, Florian Ziga, Dashurim Salitaj, Mehmet Gyl, Izmir Paja dhe Ridvan Frexhaj (imami aktual).

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 16 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2020 është rreth 264 nxënës dhe nxënëse.

Takimi me nxënësit:

Sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër në kuadër të vizitave dhe takimeve me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim-besimit, me drejtues, teologun Arben Halluni zhvilloi, pas xhumasë, më 10 korrik 2020 takimin e radhës me nxënësit e kursit fetar në xhaminë Velinaj.

Ai u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi i arsimit foli edhe për respektimin e rregullave gjatë procesit mësimor kundër përhapjes së koronaviruesit/covid-19 si dhe evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi i zellshëm Ridvan Frexhaj.

Përmes drejtuesit të arsimit, u premtua se në momentin që të përmirësohet situata e koronaviruesit do të rikthehet projekti i zhvillimit të aktivitete argëtuese dhe ekskursioneve me nxënësit e kurseve fetare në pika të ndryshme turistike.

MYFTINIA SHKODËR HAP TREGUN E RI TË FRUTA-PERIMEVE

Ditën e enjte paradite, më 2 korrik 2020, Myftinia Shkodër inauguroi hapjen e tregut të ri të fruta-perimeve në vakëfin e Zdrales.

Administratori i Myftinisë Shkodër, z. Saimir Dritareti dhe nënkryetari i Bashkisë Shkodër, z. Arben Gjuraj u shprehën përpara mediave, se hapja e këtij tregu është një shërbim i mirë dhe bashkëkohor, jo vetëm për tregtarët ambulantë, por edhe për qytetarët, të cilët tani e tutje do të blejnë nevojat e tyre në një treg bashkëkohor dhe të sistemuar mirë.

Ndërkohë, Kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi nga profili i saj në facebook, ndër të tjera u shpreh se: "Në sajë të bashkëpunimit me Myftininë e Shkodrës tregu tashmë është funksional në mjedise krejtësisht të reja dhe shumë të përshtatshme për aktivitet tregtar. Ishte Myftinia e Shkrodrës, e cila mundësoi ndërtimin e këtij tregu që jep mundësi punësimi për dhjetëra familje. Sot tregtarët e sistemuar në këtë treg, shprehen të kënaqur, ashtu siç edhe klientët e tyre që rikthehen pas rreth 2 muajve e gjysmë ndërprerje për shkak të masave për mbrojtjen nga pandemia... Bashkia Shkodër shpreh falënderimet Myftinisë së Shkodrës për mbështetjen, fermerëve dhe tregtarëve për durimin për pritjen. Duke punuar bashkë, përmirësojmë jetën tonë, ndihmojmë qytetin, familjet tona për një jetë më të mirë."

MBRËMJE FETARE NË XHAMINË E VELINAJVE

Mbrëmjen e së shtunës, më 4 korrik 2020, në vazhdën e ciklit të ri të ligjëratave me temë: "Xhamia na mbledh, drita e All-llahut na udhëzon!", u mbajt ligjërata me temë: "Sinqeriteti, sekreti i shpërblimit të veprave", nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Në ligjëratën e tij, Myftiu vuri theksin te domosdoshmëria e korrigjimit të nijetit dhe angazhimit për të kontrolluar veprat e përditshme, me qëllim fitimin e pëlqimit të All-llahut të Madhëruar në jetën tonë dhe në të përtejmen.

Ai tha se, një vepër sado e vogël, për shkak të nijetit, mund të shumëfishohet në peshoren e shpërblimeve, sikurse një vepër madhështore që mund të shumëzohet me zero për shkak të nijetit të vepruesit të saj!

Nëpërmjet haditheve, ajeteve dhe ngjarjeve nga jeta e përditshme, Myftiu tërhoqi vëmendjen që gjithsecili të kontrollojë nijetin e veprave të tij, të mos fusë hundët në punët e të tjerëve, të dojë për vëllanë e tij atë që do për vete dhe të kontrollojë marrëdhënien e tij me hallallin dhe haramin në jetë.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga imamët e nderuar, H. Ervil Kuçi (imam i xhamisë Dërgut) dhe H. Nebi Alija (imam i xhamisë së Velinajve).

Cikli i ri i ligjëratave javore do të vijojë edhe në xhami të tjera të qytetit dhe fshatit.

“AMANETI I MINBERIT...”, VIJON TRAJNIMI ME IMAMËT E MYFTINISË SHKODËR

Paraditën e së hënës, më 6 korrik 2020, vijoi trajnimi 10 javor me imamët e Myftinisë Shkodër.

Ligjërata e kësaj dite u mbajt nga teologu Gilman Kazazi, imam i xhamisë “Ebu Bekër”, i cili trajtoi temën me titull: “Amaneti i minberit në jetën e thirrjes islame”.

Gjatë ligjëratës, imami i nderuar vuri theksin tek domethënia e minberit dhe e amanetit, si dhe obligimet që ka hatibi karshi Zotit, vetes dhe xhematit të tij.

Ai solli disa shembuj të dobishëm nga jeta e dijetarëve të shkuar që lidhen me përgjegjësinë e minberit dhe vlerën e tij në edukimin dhe këshillimin e besimtarëve në mënyrë periodike.

Aktiviteti pasoi me ndërhyrjet, pyetjet dhe sugjerimet nga imamët e pranishëm.

Gjithashtu, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, pasi falënderoi ligjëruesin, dha disa mendime dhe këshilla që lidhen me hytben e xhumasë dhe amanetin e Thirrjes.

MIRËNJOHJE PËR MUEZININ DHE KUJDESTARIN E XHAMISË SË LAGJES AJASËM

Ditën e xhuma, më 10 korrik 2020, nga minberi i xhamisë së Ajasmës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, falënderoi kontributin e madh të muezinit dhe kujdestarit besnik të kësaj xhamie, të nderuarit z. Latif Ura.

Myftiu tha se brezi i ri ka nevojë të shohë në përkushtimin e “Gjyshit” të dashtun, siç e thërrasin të gjithë plakun e urtë e të përkushtuar të kësaj xhamie, modelin e sakrifikuesve për xhaminë dhe fenë!

Ai tha se ky model njerëzish janë bekim nga All-llahu i Madhëruar për të gjithë komunitetin, qytetin dhe përtej tij, prandaj duhet të gëzojnë përherë respekt dhe mirënjohje nga të gjithë!

Myftiu falënderoi në mënyrë të veçantë angazhimin këmbëngulës të kujdestarit të xhamisë së Ajasmës, z. Latif Ura për vakëfin, për xhaminë dhe ecurinë e saj.

Plaku i urtë 95 vjeçar, që me shumë pasion dhe përkushtim i shërben xhamisë së lagjes Ajasëm, si muezin dhe kujdestar, që në momentet e para të rrethimit të vakëfit, ndërtimit të xhamisë dhe përkujdesjes së vazhdueshme për të dhe gjallërimin e saj!

Me këtë rast, i dorëzoi atij një “Certifikatë Mirënjohjeje”, me motivacionin: “Për kontributin e madh dhe shërbimet plot përkushtim në rrugën e ruajtjes së traditave të vyera islame në xhamitë e Shkodrës, nëpërmjet kryerjes me devotshmëri dhe korrektësi të detyrës së muezinit në xhaminë e lagjes AJASËM.”

NË MILAN, KU PO NDËRTOHET SHTËPIA E RE PËR Z. BESIM S. MILANI

Paraditën e enjte, më 9 korrik 2020, përfaqësues të Myftinisë Shkodër panë nga afër punimet që po bëhen për ndërtimin e shtëpisë së re për familjen e z. Besim Salo Milani. Kjo nismë e mirë dhe ky kontribut i çmuar, vjen si rezultat i rinisë së lagjes Milan, Postribë, të cilët po japin shembullin më të mirë të veprave më të dashura tek All-llahu, ajo e ndihmesës dhe gëzimit të një familjeje në nevojë.

Familja e Besimit, i cili vuan edhe prej problemeve shëndetësore dhe që përbëhet nga shtatë anëtarë, aktualisht jeton në kushte të mjerueshme në një shtëpi të vjetër dhe pothuajse të pabanueshme.

Myftinia Shkodër falënderon, ata të cilët e filluan këtë nismë, por edhe angazhimin e koordinatorit të këtij projekti bamirës, z. Zamir Milani, dhe njëkohësisht bën thirrje bamirësve të ndryshëm të kontribuojnë për përfundimin e kësaj shtëpie të re, punimet e së cilës kanë nevojë për mbështetje, në mënyrë që kjo familje të jetojë në kushte dinjitoze si gjithë qytetarët e tjerë të këtij vendi.

MBRËMJE FETARE NË XHAMINË E BARBULLUSHIT

Mbrëmjen e së shtunës, më 11 korrik 2020, në vazhdën e ciklit të ri të ligjëratave me temë: “Xhamia na mbledh, drita e All-llahut na udhëzon!”, u mbajt ligjërata me temë: “Modeli i rinisë në Kur’an”, nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Në ligjëratën e mbajtur pas namazit të akshamit, Myftiu falënderoi fillimisht imamin e xhamisë, H. Ervis Molla, për angazhimin e tij plot përkushtim ndaj xhematit, xhamisë dhe në mënyrë të veçantë djemve dhe vajzave që frekuentojnë kurset e vazhdueshme fetare në këtë xhami.

Myftiu foli edhe për rëndësinë që ka shoqëria e mirë e xhamisë, lidhja pas saj dhe forcimi në besim dhe Islam, për të garantuar një shoqëri vlerash.

Më pas, u ndal tek tefsiri i ajeteve të para të sures “El-Kehf”, ku theksoi se muslimani i ri duhet të marrë si shembull jete të rinjtë e Shpellës, që me besimin e tyre, me kurajon dhe vendosmërinë e dëshmuar, u bënë shembulli më i mirë për brezat e ardhshëm.

Ai tha se këta të rinj nuk u thyen asnjëherë përballë paragjykimit, injorancës, pengesave të shumta në shoqërinë e tyre, por qëndruan dhe nuk hoqën dorë nga besimi, derisa Zoti i gjithësisë i bëri shembull udhëzimi për ne deri në ditën e fundit.

Për kënaqësinë e të pranishmëve në këtë ligjëratë, vajzat e kursit të xhamisë së Barbullushit kënduan një ilahi të bukur.

Cikli i ri i ligjëratave javore do të vijojë edhe në xhami të tjera të qytetit dhe fshatit.

“LEHTËSONI, MOS VËSHTIRËSONI...”, LIGJËRATA E TRETË E TRAJNIMIT ME IMAMËT E SHKODRËS

Paraditën e së hënës, më 13 korrik 2020, vijoi trajnimi 10 javor me imamët e Myftinisë Shkodër, ku ligjërues i radhës ishte teologu dhe studiuesi islam, Dr. Ferid Piku.

Në ligjëratën e tij, Dr. Ferid Piku trajtoi temën: {Thirrësi islam, rrugëtues besnik me hadithin: ‘Lehtësoni, mos vështirësoni...’}, ku hodhi dritë mbi rrugët e shumta të përfitimit nga ky hadith i shquar në jetën e thirrësve islamë, misioni i të cilëve është i lidhur ngushtë me shembullin e Resulull-llahut (a.s.).

Nëpërmjet shembujve të shumtë, ai tha se imamët e sotëm duhet të angazhohen përherë e më shumë për të qenë pranë besimtarëve, për të dhuruar qetësim e siguri, për t’u bërë pikë referimi në jetën e muslimanëve, për të dhuruar besim e garanci për njerëzit.

Ndërhyrje me vlerë bënë edhe imamë të pranishëm, që dhanë mendime të vyera dhe reflektime me dobi rreth temës.

Gjithashtu, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, pasi falënderoi ligjëruesin për pranimin e ftesës dhe trajtimin plot vlerë të kësaj teme, solli disa shembuj nga neta e hoxhallarëve të shquar të shekullit, në modelin e të cilëve pasqyrohet shumë mirë përkthimi në realitet i hadithit: “Lehtësoni, mos vështirësoni...”.

"PERSONALITETE FETARE, PERSONALITETE KOMBËTARE" LIGJËRATA E KATËRT E SEMINARIT TRAJNUES ME IMAMËT E SHKODRËS

Të hënën, më 20 korrik 2020, vijoi trajnimi 10 javor me imamët e Myftinisë Shkodër, ku ligjërues i radhës ishte historiani i njohur, studiuesi Dr. Ardian Muhaj, aktualisht drejtor i "Institutit Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam"(AIITC), Tiranë.

Dr. Muhaj, pas falënderimit për Myftininë Shkodër për organizimin e këtij seminari të rëndësishëm dhe për ftesën e tij, për të qenë pjesë e këtij trajnimi me vlerë, foli për rolin dhe kontributin e personaliteteve të shquara fetare e atdhetare, si Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ali Kraja, Mulla Idriz Gjilani, H. Muhamed Çami, etj, në ngritjen kombëtare, si dhe ruajtjen e kultivimin e brezave me dashurinë për fenë dhe atdhedashurinë.

Dr. Muhaj, theksoi se ishin këto personalitete fetare dhe kombëtare që patën një kontribut të çmuar në Rilindjen Kombëtare, si dhe duke njohur rëndësinë e madhe të arsimimit të popullit shqiptar, përveç përpjekjeve për liri kombëtare, një krah të zhvillimit të veprimtarive atdhetare ia kishin kushtuar edhe hapjes së shkollave në gjuhën shqipe.

Ligjëruesi solli edhe shembuj konkret nga Libri i Krijuesit të Gjithësisë, ku Allahu (xh.sh.), pavarësisht se i krijoi

njerëzit në popuj (kombe) e fise, i dha mundësinë e njohjes ndërmjet vete, si dhe dështimin me seriozitet e korrektësi si mëkëmbës të Zotit Një!

Binomi fé-atdhe, sipas Dr. Muhaj duhet të na thërrasë drejt tolerancës, bashkëjetesës paqësore dhe me dinjitet, si dhe mirëkuptimit, duke respektuar vlerat e njëri-tjetrit, pa hile e fshehje të urrejtjes dhe nënçmimit.

Më pas, disa prej imamëve të pranishëm bënë pyetje dhe dhanë mendimet e tyre në lidhje me temën e seminarit.

Në fund, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, pasi falënderoi ligjëruesin për trajtimin e kësaj teme plot dobi dhe të nevojshme, theksoi se gjurmët e hoxhallarëve të shkuar, e deri në ditët e sotme, në raportet e shërbimeve për çështjen kombëtare janë të panumërta.

Ai tha se falë studimeve, emrat dhe gjurmët konkrete të prijësve fetarë muslimanë janë të regjistruara, të botuara dhe në dorëshkrime dhe se imamët e sotëm, por edhe studiuesit, intelektualët dhe masat e gjera, duhet të jenë mirënjohës për shembulltyrën e hoxhallarëve dhe personaliteteve të shquara fetare islame në ngritjen dhe ruajtjen e vetëdijes fetare dhe kombëtare tek ne.

KURBAN BAJRAMI, DITË E MADHE E BESIMIT DHE DINJITETIT ISLAM

Ditën e xhuma, më 31 korrik 2020, sipas lajmërimit zyrtar të Myftinisë Shkodër, besimtarët muslimanë shkodranë mbushën xhamitë dhe oborret e tyre, për të marrë pjesë në ceremoninë tradicionale të Kurban Bajramit.

Në xhaminë e Fushë Çelës, (xhamia "Ebu Bekër"), ishte i pranishëm edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili iu drejtua të pranishëmve me një mesazh të posaçëm të kësaj dite.

Myftiu tha se dita e sotme është momenti i reflektimit në madhështinë e thirrjes: "All-llahu ekber", si dhe dështimit të saj në jetën e përditshme, si çelës i suksesit, sigurisë dhe krenarisë në komunitet!

Ai tha se dita e Kurban Bajramit është dita e familjes dhe e përkujdesjes për edukimin e rinisë dhe brezit të ri, duke ecur pas gjurmëve të Ehli-Bejtit, familjes së bekuar të Hz. Ibrahimit (a.s.), që janë simboli i kësaj dite dhe historie të shënuar të përjetësuar deri në ditën e fundit.

Myftiu bëri thirrje që shoqëria të

shohë realitetin e zhvillimeve të jetës në vendin tonë, duke refuzuar padrejtësitë, korrupsionin, mashtrimin dhe taborrat e atyre, që prej dekadash po e shkatërrojnë vendin, duke e vështirësuar jetën e rinisë në këtë tokë të begatë!

Ndërkohë, në hytben e kësaj dite, imami i xhamisë, teologu Idmir Plaku, hodhi dritë mbi vlerën dhe simbolikat e ditës së Kurban Bajramit, sikurse porositi që njerëzit të shfrytëzojnë adhurimin e kurbanit, si mënyrë afrimi me All-llahun e Madhëruar dhe mundësi e përhapjes së shpirtit të bamirësisë në shoqëri.

QENDRA SHQIPTARE PËR INTEGRIM, KULTURË DHE RELIGJION, LOZANË NDIHMON 100 FAMILJE PËR KURBAN BAJRAM

Festa e Kurban Bajramit sjell përherë mirësi e bekim, që mishërohet shumë mirë edhe në bashkëpunimin e besimtarëve me njëri-tjetrin, duke bërë që atmosfera e ditëve të Bajramit të rrezatojë çdo të mirë për krejt shtresat e shoqërisë.

Falë bashkëpunimit të Myftinisë Shkodër me Qendrën Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion në Lozanë të Zvicrës, u mundësua, që në ditën e Kurban Bajramit të sivjetshëm të ndihmohen 100 familje në nevojë duke bërë të mundur shpërndarjen kurbaneve të ardhura nga vëllezërit tanë në Lozanë.

Me këtë rast Myftinia Shkodër shpreh falënderimet dhe mirënjohjen e saj për QSHIKR, Lozanë dhe drejtuesin e saj, të nderuarin, Mr. Fehim Abazi.

MYFTINIA SHKODËR DHE "HELPING HAND USA" SHPËRNDAJNË KURBANE PËR FESTËN E BAJRAMIT

Pasditen e ditës së xhuma, më 31 korrik 2020, në ditën e parë të Kurban Bajramit, Myftinia Shkodër me mbështetjen e "Helping Hand For Relief and Development (HHRD Global)" të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me rastin e festës së begatë të Kurban Bajramit bënë shpërndarjen e 50 pakove me mish kurbani për personat me aftësi ndryshe.

Përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Lavdrim Hamja uroi festën e Kurban Bajramit vëllezërve dhe motrave të kësaj shtrese të veçantë të shoqërisë sonë, duke theksuar se institucioni i Myftinisë Shkodër nuk i harron asnjëherë dhe i ka gjithmonë në vëmendje, sidomos me rastin e festave islame.

Kryetari i shoqatës së invalidëve "Para & Tetrapelgjikë", z. Saimir Beqiri falënderoi Myftininë Shkodër dhe "Helping Hand USA" për këtë bashkëpunim dhe kontribut me vlerë, në ndihmë të këtyre personave, sikurse shprehu mirënjohjen e shoqatës për bashkëpunimet e ndryshme me Myftininë Shkodër.

Falënderim dhe mirënjohje!

Myftinia Shkodër shpreh falënderimet e saj më të përzemërta për kontribuuesit, që iu bashkuan thirrjes për realizimin e kurbaneve me rastin e festës së Kurban Bajramit, në përkrahje të nevojtarëve dhe skamnorëve të ndryshëm.

All-llahu i shpërbleftë me mirësitë e Tij të pakufishme.

Në veçanti:

- Qendra Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion, Lozanë - Zvicër.
- "Helping Hand For Relief and Development (HHRD Global)" - USA.
- Shoqata "Istanbul", Shkodër.
- Fondacioni "Mirësia", Tiranë.
- Besimtarë dhe bamirës të ndryshëm në Shkodër, por jo vetëm, të cilët dhuruan kurbanet e tyre për Myftininë Shkodër.

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek